



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

## EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tetë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më  
14.10.2024, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, ( i pavarur), kryesues i Kuvendit, Tria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Berna Saraçi (LVV), Feim Osmani (LVV), Berat Lahu (LVV), Edmond Azemi (LVV), Violeta Salihu (LVV), Arbër Limani (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Faton Zeka (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Amir Simnica (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Milazim Vitija (LDK), Sami Salihu (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Xhavit Ahmeti, (AAK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB) dhe Endrit Zabërgja (NISMA).

**Munguan:** Petrit Reçica (LVV) dhe Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK).

**Të pranishëm ishin edhe:** Përparim Rama, kryetar, Alban Zogaj, nënkryetar, Valbona Ajeti, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Arbër Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Izet Sadiku, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Donika Çetta, dejtore e Drejtorisë së Parqeve, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të qytetarëve dhe përfaqësues të medieve.

## Faqe 1 nga 12

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Kushtrim Mushica**, kërkoi që në rend të ditës të hyjnë propozim-vendimet për subvencionimin e klubeve elitare të sportit të Prishtinës, sipas kërkesës së Ministrisë së Financave.

**Gëzim Sveçla** tha se, sa i përket propozimit të z. Mushica, kërkoi të dijë se a ka ndryshuar diçka në bazën ligjore që po dëshirojmë me e diskutu ketë ndryshim dhe nëse janë të njëjtat kondita si atëherë kur është votu dhe nëse baza ligjore është e njëjta prapë i bie lajthitje ndaj asamblesë, për shkak që prapë e njëjta ka me u kthi nga Ministria.

**Arbër Sadiki**, kërkoi që në rend të ditës të hyjnë pikat: Propozim-vendimi për ndërrimin e destinimit të bll. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, dhe Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale zonës së banimit të planit rregullues Prishtina e Re - Zona Perëndim".

**Gëzim Sveçla** tha se sa i përket propozimit të drejtorit, mendoj se çështjet të cilat i përkasin drejtësisë nuk është në rregull që Kuvendi me i diskutuar ato, mendoj se këtu është perzirje e politikes në çështjen të drejtësisë.

**Bahri Gashi** tha se pikat të cilat po propozohen nga drejtorët, mendoj se është legjitime që ato të futen në rend të ditës dhe të diskutohet për to.

**Gëzime Mehmeti** tha se ne jemi këtu për me i'u bë zgjidhje, qytarëve, por nëse në këto propozim- vendimet vërehet ndonjë parregullësi, kërkoi nga drejtori që të sqarohen çështjet dhe të hiqen të gjitha dilemat rreth këtyre propozim-vendimeve.

**Jeta Rafuna**, kërkoi që pikat e propozuara nga z. Sadiku, drejtot, të hyjnë në rend të ditës për diskutim.

**Kumrije Shabani**, propozoi që në rend të ditës të hynë pika: Diskutim për situatën e krijuar nga qenët endacak.

**Agim Kuleta** tha se proceduralisht në mbledhje vjen rendi i propozuar nga kryesuesi dhe kryetari, e në mbledhje mundet të propozohet, të hiqet pikat e rendit të ditës, të diskutohet dhe votohet, sepse nuk mundet një organ që është i themeluar nga Kuvendi (KPF) të vendos se çfarë do të diskutoj Kuvendi, ajo mund të jap vetëm rekomandime Kuvendit.

**Leutrim Retkoceri**, propozoi që në rend të ditës të hynë pika: Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave.

**Endrit Zabërgja**, kërkoi nga gjithë të pranishmit që, mos të bëjmë lojra politike me këto tema kaq të ndjeshme, në veçanti për çështjen e pastrimit të qytetit, po të përkrahim çdo pikë çdo iniciativë e cila Kryqytetin do të bënte më të pastër ashtu siç ka filluar Drejtorja e Shërbimeve Publike të punoj në këtë aspekt.

### **Kryesuesi i hodhi në votim pikat e propozuara**

**Kryesuesi konstatoi se më 4 vota për dhe 32 vota kundër, nuk u miratua propozim i z. Mushica, Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve për subvencionimin klubeve sportive dhe nuk hynë në rend të ditës për diskutim.**

Kryesuesi konstatoi se më me 19 vota për, 22 kundër dhe 1 abstenim, nuk u miratua propozimi i z. Sadiki, Propozim-vendimi për ndërrimin e destinimit të bl. I-1, Q-2, I-2, sipas destinimit të PZHU-së, dhe nuk hynë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 20 vota për, 23 vota kundër dhe 1 abstenim nuk u miratua propozimi i z. Sadiku, Propozim-vendimi për ndryshimin e riparcelimit sipas gjendjes aktuale kadastrale (te banimi individual), të Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim" në Prishtinë, dhe nuk hynë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, u miratua propozimi i znj. Shabani, Diskutim për gjendjen e krijuar nga qenët endacak në qytet, dhe hynë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 22 vota për, 15 kundër dhe 2 abstenim, u miratua propozimi i z. Retkoceri, Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave, dhe hynë në rend të ditës për diskutim.

Me ndryshimet dhe propozimet e dhëna, kryesuesi konstatoi se më 35 vota për, u miratua ky

#### Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së shtatë dhe të jashtëzakonshëm të Kuvendit të Kryqytetit;
2. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik për ndryshim-plotësimin e Rregullores së menaxhimit të mbeturinave;
3. Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punët në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, nr. -1-020/04-215695/23, dt. 3.11.2023;
4. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Projekt-planit lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026;
5. Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë;
6. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2023 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit;
7. Informatë mbi punën e Njesisë së Auditimit të brendshëm për vitin 2023;
8. Diskutim mbi gjendjen e krijuar lidhur me qenët endacak;
9. Informatë e punës 1 janar-31 gusht 2024, i NPL" Pallati i Rinisë ";
10. Pyetje dhe përgjigje;
11. Të ndryshme.

**Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së shtatë dhe të jashtëzakonshëm të Kuvendit të Kryqytetit**

**Kryesuesi konstatoi se më 34 vota për dhe 1 abstenim, u miratua ekstrakti i procesverbalit të seancës së shtatë dhe të jashtëzakonshëm të Kuvendit të Kryqytetit.**

**Pika dytë**

**Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik për ndryshim-plotësimin e Rregullores së menaxhimit të mbeturinave**

**Leutrim Retkoceri** tha se Ministria që benë monitorimin vendimeve të Kuvendit ka kërkuar që të bëhet një ndryshim i paragrafit të Rregullores për menaxhimin e mbeturinave dhe që këto ndryshime të dërgohen për dëgjim publik dhe pastaj ti kthehen Kuvendit pas afateve ligjore për rishqyrtim dhe votim.

**Kryesuesi konstatoi se më 21 vota për dhe 1 kundër, u miratua Vendim për vënien në diskutim publik për ndryshim-plotësimin e Rregullores së menaxhimit të mbeturinave.**

**Pika e tretë**

**Propozim-vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për caktimin e Komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punët në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, nr. -1-020/04-215695/23, dt. 03.11.2023.**

**Bahri Gashi**, propozoi z. Xhavit Ahmetin, anëtar të Komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punët në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, z. Xhavit Ahmetin caktohet anëtar i Komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punët në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.**

**Valbona Ajeti**, drejtore, për kryesues të Komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punët në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane e propozoi veten.

**Kryesuesi konstatoi se më 24 vota për, znj. Valbona Ajeti, drejtore, caktohet kryesuese e Komisionit për të udhëhequr dhe koordinuar punët në terren në përzgjedhjen e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.**

## **Pika e katërt**

### **Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Projekt-planit lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026**

Lidhur me Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Projekt-planit lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Premtime Preniqi, zyrtare e të drejtave të njeriut dhe barazi gjinore.

**Violeta Salihu** tha se Grupi i lëvizjes Vetëvendosje në parim e përkrah daljen në diskutim publik të Planit lokal të veprimit për barazi gjinore sepse e vlerëson që është mjet kryesor i zbatimit dhe angazhimeve publike për barazi gjinore i cili reflekton dokumentet kryesore të vendit siç është Kushtetuta e Republikës së Kosovës, pra është edhe instrumentet kryesor ndërkombëtar për barazi gjinore. Është një dokument i hartuar edhe përmes një procesi gjithpërfshirës, ku reflektohen arritjet dhe sfidat të ndeshura nga Komuna në përparime drejt barazisë gjinore. Gjithashtu ky plan është pasqyrim i qartë i roleve dhe përgjegjësive të domosdoshme për të përmbushur brenda Komunës si dhe ndërmjet Komunës institucioneve lokale apo organizatave të shoqërisë civile, si ato ndërkombëtare ashtu edhe ato vendore.

**Jeta Rafuna** tha se ne si grup e mirëpresim këtë Plan-veprim të dal në diskutim publik. **Kumrije Shabani** tha se edhe ne si grup i PDK-së e mbështesim këtë nismë për dëgjim publik dhe e përkrahim.

**Gëzim Mehmeti** tha se barazia gjinore është shumë me tepër së një parim ligjor apo një kërkesë politike, është një forcë intelektuale që sfidon dhe përmirëson mënyrën se si të shohim botën.

**Kryesuesi** konstatoi se më 32 vota për, u miratua Vendimi për vënien në diskutim publik të Projekt-planit lokal të veprimit për barazi gjinore 2024-2026.

## **Pika e pestë**

### **Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë.**

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Izet Sadiku, drejtor.

**Gëzim Sveçla** tha se kemi disa vërejtje për disa nene si në vijim: Neni 6, pika 9, neni 7, pika 1.4, neni 9, pika 1.16, neni 11 pika 7, neni 12 pika 6.2, neni 14 pika 2.1, neni 19 pika 2.1.2, neni 26 pika 2, dhe neni 12, pika 6. Kërkoj që të korigjohen edhe një herë këto nene, dhe nëse këto vërejtje të cilat ne i shprehëm inkorporohen në tekstin final, ne e mbështesim votimin e këtij statuti.

**Elmire Nikiçi - Rexha** tha se duke marrë parasysh që ky dokument zyrtar rregullon organizimin dhe funksionalizimin e QKMF-ve në Kryeqytet, pra ka të bëjë me organizmin e

kujdesit parësor, shëndetësor publik që synon të siguroj ofrimin e shërbimeve shëndetësore gjithëpërfshirëse, ne si grup i LDK-së e përkrahim dhe e votojmë këtë statut.

**Leutrim Retkoceri** tha se duke pasur parasysh diskutimet paraprake, do të kishte qenë e mirëseardhur që sikurse vërejtjet të ishin inkorporua nga dëgjimi publik me qytetarë profesionistë në mënyrë që edhe ata të kenë të drejtën e tyre të shprehin komentet, mendimet dhe vlerësimet e tyre. Po ashtu do të ishte mirë që edhe ne si anëtarë të Kuvendit që të i japim komentet tona, kështu që e përshëndesim një nisëm të tillë.

**Gëzim Mehmeti**, kërkoi nga propozuesi i kësaj pike që të ta merr një interpretim ligjor nga Zyra ligjore se a është në harmoni me ligjin një propozim i tillë, por megjithatë tha se, kisha propozuar që të shtyhet ky proces deri sa të bëhen sqarimet e nevojshme.

**Nora Kelmendi**, kërkoi të dijë se a është marrë pëlqimi nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë që statutet mund të adaptohen nga komuna sipas udhëzimit, kështu që ne nuk e kemi këtë dokument të Ministrisë.

Lidhur me vërtjetet dhe sugjerime e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha Izet Sadiku, drejtor.

**Kryesuesi konstatoi se më 26 vota për, u miratua Statuti i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë.**

**Pika e gjashtë**

**Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2023 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit.**

Lidhur me Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2023 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Osman Bllaca.

**Gëzim Sveçla** tha se Raporti i auditimit për vitin 2023 mbi pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës është konfirmim i sakt dhe dokumentar i akuzave dhe kritikave që i kemi bërë si Lëvizje Vetëvendosje për Komunën e Prishtinës përkatësisht për zyrtarët e Komunës që punojnë dhe e menaxhojnë procesin në Kryeqytet. Kemi vërejtje shkelje të shumta dhe pagesa anti ligjore, favorizime biznesesh, mos funksionim i kontrollave të brendëshme e mungesë e përgjegjësisë për zbatimin e kërkesave dhe nevojave ligjore. Raporti i auditorit të përgjithshëm bazuar në dëshmit e marrura nga auditimi ka zbuluar keq deklarime dhe mospajtueshmëri dhe si rezultat i tyre e ka vlerësuar këtë raport me opinion të kualifikuar, që dëshmonë për shumë shkelje ligjore. Disa nga gjetjet kryesore janë me të vërtetë shqetësuese dhe tregojnë për qasjen që ka ky ekzekutivë në raport me mënyrën e qeverisjes në Kryeqytet në përgjithësi e specifikisht tek keq përdorimi dhe abuzimi me financa publike etj.

**Fiknete Bejta** tha se krahasuar me raportet paraprake vërehet një dozë optimizmi, është shkalla e progresit të zbatimit të rekomandimeve të auditorit gjeneral dhe shohim që një numër i madh i rekomandimeve janë të zbatuara, dmth janë të kryera, ndërsa si pasojë e mos zbatimit janë vetëm 8 rekomandime të përsëritura nga vitit 2022, ku 3 rekomandime janë pjesërisht të zbatuara dhe këto rekomandime janë indirekt të lidhura me ligjshmërinë që e kanë.

Si grup parlamentar i LDK-së, inkurajojmë Zyrën e auditorit, drejtoritë dhe të gjithë ekzekutivin që të i marrë për bazë të gjeturat e auditorit, rekomandimet që ti zbatojnë këto rekomandime në përpikmëri.

**Agron Canolli** tha se në këtë raport janë të evidentuara mangësitë e vazhdueshme që kërkojnë vëmendje dhe përmirësim urgjent në disa fusha të caktuara. Në vitin 2023, numri i gjetjeve është rritur, në 22, prej të cilave 9 ishin të përsëritura nga vitet e mëparshme, ndërsa 13 ishin gjetje të reja. Rezultatet e zbatimit tregojnë se rreth 54.55% e rekomandimeve mbeten të pazbatuara, ndërsa 22.73% u zbatuan pjesërisht. Shumica e këtyre gjetjeve lidhet me proceset në fushën e prokurimit, përkatësisht tenderat, dhe menaxhimin e projekteve dhe kontratave. Prandaj, është e domosdoshme që këto problematika dhe devijime nga rregullativa ligjore të reflektohen me kujdes nga ekzekutivi dhe të sigurohen se sistemet e ndërtuara të kontrollit të brendshëm të jenë më efikase. Si anëtar të Kuvendit Komunal, kemi përgjegjësi dhe të kërkojmë përmirësime të menjëhershme në mënyrë që këto rekomandime të merren seriozisht dhe të eliminohen nga ekzekutivi, për të garantuar përputhshmërinë dhe transparencën financiare për vitet e ardhshme dhe eliminimin e keqpërdorimeve eventuale.

**Gëzim Mehmeti** kërkoi të dijë nga z. Bllaca se sa opinione të raporteve të auditimit i kemi. **Violeta Salihu** tha se, duke u bazuar në raportin e auditimit të pasqyruave financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2023 janë vërejtur se ka të gjeturë që duhet të ju kushtojmë vëmendje me nevojë të madhe të përmirësimit në mënyrë që të arrihet një menaxhim efikas, financiarë dhe zbatim të rregulloreve të aprovuara po në këtë Kuvend.

**Muhamet Selmani** tha se vërejtja ime ka të bëjë me gjobat që ka marrë Komuna e që janë kryesisht 476 mijë euro si rezultat i mospagesave të faturave të punëve, shërbimeve të kryera në Komunë. Kërkoi një opinion nga Drejtoria e Administratës, nga Zyra ligjore dhe nga audori se a kanë filluar procedurat disiplinore apo masat ndaj zyrtarëve të cilët kanë lejuar këto sepse nga përvoja që kamë është kryesisht si rezultat i keqpërdorimit të pozitës zyrtare apo neglizhencës së punës së zyrtarit të caktuar që ndodhin këto raste.

**Triera Kasumi - Berisha** tha se mos prezenca e kryetarit në mbledhje është totalisht papërgjegjësi, është e papranueshme, pasi që vërejtet tona ne nu po dijmë se kujt po ja dërgojmë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dhan Osman Bllaca dhe Valbona Makolli, drejtore.

## **Pika e shtatë**

### **Informata mbi punën e e njësisë së auditimit të brendshëm të vitit 2023.**

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Osman Bllaca.

**Nora Kelmendi**, shprehu shqetësim rreth këtij dokumenti e cila tha se, ky nuk është plan i punës as raport i punës së drejtorive se nuk po e shohim asnjë rekomandim nga të gjeturat, pra ky plan i sjellur nga auditimet e brendshme nuk ka të gjetura edhe nuk kemi procese të cilat ju i numroni që duhet me i përmirësu. Do të kishte qenë mirë me elaboru pak me shkrim dhe më pas me i sjellur ato rekomandime se çka keni vendosë.

**Muhamet Selmani** kërkoi të dijë se gjatë auditimit të drejtorive të ndryshme a i keni ivedentuar ndonjëren prej shkeljeve të cilat i ka cekur auditori gjeneral në raportin e tij të punës, siç janë: Mos regjistrimi i shpenzimeve kontigjente, gjobat, mospagesa e faturës etj.

Lidhur me shqetësimet dhe sugjerimet e dhëna nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha Osman Bllaca.

## **Pika e tetë**

### **Diskutim mbi gjendjen e krijuar lidhur me qentë endacak.**

Lidhur me gjendjen e krijuar nga qentë endacak, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Kumrije Shabani e cila tha se nga qent endacak po rrezikohet siguria e qytetarëve. Ne nuk mund të lejojmë që një problem i tillë të injorohet më tej, qytetarët presin nga ne si përfaqësues të tyre që të ngrisin zërin fuqishëm për ndërmarrjen e masave të shpejta dhe emergjente, nga ekzekutivi i komunës për zgjidhjen e kësaj qështjeje.

**Gëzim Sveçla** tha se është për të përshëndetur iniciativa e asambleistës për të diskutuar mbi këtë qështje, e që është një prej problemeve kryesore të kryeqytetit, problem i aspektit të sigurisë me të cilin po ballafaqohemi çdo ditë e më shumë e që këtë qështje duhet ta trajtojmë me një seriozitet më të madh, mirëpo fatkeqësisht praktika po e dëshmon që numri i rasteve të sulmeve të qenve endacak ndaj qytetarëve të Prishtinës nuk është se po zvogëlohet përkundrazi duket se ka një rritje të tyre, e kjo është mjaftë shqetësuese.

**Pëllumb Bajqinovci** tha se e kemi hartuar strategjinë kornizë njëmbëdhjetë pikëshe për trajtimin e qenve endacak përkrahë nga gjithë akterët brenda dhe jashtë kryeqytetit, andaj mendoj se kjo qeverisje ka bërë maksimumin në situatën të cilën jemi dhe sigurisht se do të vazhdojmë më tutje deri në përfundimin e kësaj problematike e cila nuk mund të realizohet brenda 24 orëve dhe kërkon kohë.

**Leutrim Retkoceri** tha se është vërtetë shqetësuese situata me sulmet e qenve endacak ndaj qytetarëve dhe mendoj që është një kohë e gjatë që kjo qështje nuk po trajtohet me shpejtësinë e nevojshme. Me gjithë punën dhe angazhimin nuk është e mjaftueshme sepse rastet po tregojnë që me informata që kanë qenë në media janë më shumë se 80 raste vetëm këtë vit të qytetarëve të cilët kanë pësuar nga kafshimet e qenve endacak, mirëpo janë edhe disa zotime të cilat aspak nuk janë përmbushur nga kryetari Përparim Rama.



**Gëzim Mehmeti** tha se për zgjidhjen e kësaj çështjeje duhet të jet një koordinim i duhur mes institucioneve lokale dhe qendrore dhe kërkoi të dijë se a ka ndonjë plan veprimi se si të veprohet më tutje për zgjidhjen e këtij problemi.

**Granit Geci** tha se po flasim për një dukuri e cila është shqetësim ditor për qindra e mijëra njerëz qytetarë të kryeqytetit, dhe Përparim Ramës nuk i bënë aspak përshtypje, kjo është fatkeqësi, dhe këtë nuk po e them nga prizmi i opozitarit, po e them së pari si qytetarë, po e them si banor i Prishtinës i cili çdo ditë sheh ballafaqime të qytetarëve me qentë endacak. E përgëzoj çdo iniciativë që merret tani, që është marrë në të kaluarën dhe do të merret në të ardhmen për zgjidhjen e këtij problemi.

**Faton Zeka** tha se a ka ndonjë hapësirë ligjore me shpallë ndonjë gjendje emergjente edhe nëse ka nevojë edhe ne si Kuvend po e ndërmarrim një hap edhe po e zgjerojmë mundësinë financiare të trajtimit të qenve nëse na lejohet me buxhet, normal gjithmonë nëse ka hapësira ligjore. Unë si asamblist iu bëjë thirrje juve si ekzekutiv që ta shtrini dorën e bashkëpunimit me nivelin qeveritar, të kërkoni ndihmë prej tyre sepse e dimë që pa ndihmën e qeverisë nuk zgjidhet ky problem.

Lidhur me shqetësimet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit rreth situatës së krijuar nga qentë endacak, sqarime të nevojshme dha Bekim Brestovci, drejtor.

#### **Pika e nëntë**

#### **Informatë e punës 1 janar 31 gusht 2024 NPL " Pallati i Rinisë"**

Lidhur me punën e NPL të pallatit të Rinisë për periudhën 1 janar- 31 gusht të pranishmit në pika të shkurtra i informoi Fiknete Bejta, në cilësinë e anëtarit të Komisionit komunal të aksionarëve në këtë ndërmarrje .

**Faton Zeka** tha se për grupin tonë janë disa shqetësime, që besoj duhet pasë përgjigje si staf menaxhues e besoj që duke filluar nga rasti i fundit i arrestimeve që ndodhën në ndërmarrje, për keqpërdorime direkte me mjete financiare nga zyrtarë menaxhues, e që për ne kjo përbënë një krim që duhet marrë përgjigje të merituar nga drejtësia. Është krijuar përshtypje që ndërmarrjet publike janë krijuar për t'i keqpërdorur nga militant të dërguar si zyrtar të lartë të ndërmarrjes publike. Kërkoi të dijë se stafi menaxhues a ka qenë në dijëni i njoftuar më herët për këtë keqpërdorim dhe cilat dhe cilat kanë qenë masat që i keni ndërmarrë si staf menaxhues i ndërmarrjes dhe pse nuk ka ndodhur suspendimi i keqpërdoruesve të parasë publike. Ne si komunë e kemi subvencionuar Pallatin e Rinisë me shumën të mëdha, mjete të taksave të qytetarëve, ndërsa në ndërmarrje keqpërdorohen dhjetëra mijëra euro etj.

**Leutrim Retkoceri** kërkoi të dijë se çka është diskutuar në një takim me kryetarin dhe me përfaqësuesin e biznesit për të negociuar dhënien në shfrytëzim të Pallatit të Rinisë. **Gëzim Sveçla** kërkoi të dijë se, cilat janë arsyet që kjo ndërmarrje i ka lëshuar zyrat në të cilat ka qenë me qera në Pallatin e Rinisë dhe ka shkuar në një objekt në pronësi private. Cilat janë borxhet e komunës ndaj Pallatit të Rinisë, ose cila është logjika me kërkuar subvencion prej Kuvendit Komunal, kur Komuna ua ka rreth gjysmë milioni euro borxh. Pse nuk po i kërkoni parkingjet të Pallatit, pjesa që është te Duplexi edhe parkingu tjetër në udhëkryqin e BQK-së, këto janë me qera, pse nuk po i ktheni në pronësi të Pallatit.

Lidhur me vërejtet dhe sheqtesimet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit, sqarime të nevojshme dha Fiknete Bejta.

### **Pika e dhjetë Pyetje dhe përgjigje**

#### **Radie Hoxha, pyetje për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë.**

Në gazetën "Dhjetë" në një intervistë që e ka bërë dr. Izet Sadiku, drejtor, po e citi, thotë kështu: Qytetarët me kancer dhe smundje të rënda kronike, e ka fjalën për këtu në Prishtinë, ndihmohen me ka 250 euro në muaj, që nuk është e vërtetë hiq d.m.th ndihmohen me ka 250 euro në vitë, jo në muaj. Ai po ashtu ka cekur se nga Komuna e Prishtinës për personat me kancer dhe smundje tjera kronike, në çdo muaj ndahen nga 250 euro nga këta të sëmurë me kancer që nuk është e vërtetë, ndahen 250 euro njëherë në vit dhe jo për të gjithë pacientët. Konsideroi se Komuna e Prishtinës ndanë më së paku mjete financiare për të smurët me kancer.

**Granit Geci** tha se një qytetari ju ka bërë e pa drejtë e që ai ankohet për një diskriminim edhe një mospërbushje të zotimit të Kryetarit Rama që momentin kur është hartu Plani i hollësishëm për lagjen Kalabria, është e vetmja pjesë e lagjes e cila që nuk është trajtu në mënyrë të barabartë, siç janë trajtu të tjera, pra më saktësisht nëse nuk gaboj bëhet fjalë për çështjen e koficientit edhe është e vetmja pjesë prona e ti, ku është koficienti 1.5, në të gjitha të tjerat minimum është 2.4 dhe e konsideroj ky gabim ka qenë edhe shqetësim edhe i mëhershëm edhe i këtij banori.

#### **Faton Zeka, për nënkryetarën e Komunës**

Banorët e Matiqanit kanë një shqetësim për shkollën në atë lagje e cila në njërin anë është e parrethuar me rrethoja mbrojtse dhe rrjedhimisht ata kanë frikë për fëmijët e tyre që mund dalin direkt në rrugë dhe kërkojnë që të bëhet kjo rrethojë për shakk të sigurisë së fëmijëve të cilët mos të dalin direkt në rrugë.

**Gëzim Sveçla** tha se i kemini një një vargë pyetjesh për drejtorët e drejtorive përkatëse, për të cilat ish dashtë Kryetari me qenë këtu, por këtu nuk po janë prezent as edhe disa drejtor të drejtorët e drejtorive përkatëse.

**Besart Krasniqi** tha se e kam dorzuar një kërkesë në Drejtorin e Shërbimeve Publike, që kanë të bëjë me hapjen e varrezave, shpenzimeve dhe procedurave tjera të varrimit për fshatrat Matiqan, Zllatar, Hajvali dhe Bardhosh, ku ata dëshirojnë, kjo veprimtari e hapjes së varrezave të bëhet në kuadër të Ndërmarrjes Publike. Multikultura sepse po keqpërdoret nga persona të pandërgjegjshëm si nga ana joprofesionale që bëjnë hapjene varreve, poashtu edhe parave duke kërkuar shumën të ndryshme.

Po ashtu kemi edhe disa ankesa nga ndërmarrja "Trafikun Urban" ku ikam listu disa që më kanë ardhë prej punëtorve aty, si rreth punsimeve enorme, keqpërdorim i buxhetit të ndërmarrjes, blerje e telefonave, llaptopa etj.

Kam pranuar edhe ankesë që ka të bëjë me shportat në Kryeqytetë. Ata kërkojnë që të bëhen më shumë shporta në kryeqytet.

Kërkesa tjetër ka të bëjë me rrugën "Fahri Fazliu", në fillim të rrugës "Fahri Fazliu" Kodra e Trimave, rruga është mjaftë e dëmtuar me gunga e në këtë mënyrë paraqet problem si për vozitje të automjeteve si dhe po dëmtohen veturat. Po ashtu edhe një pjesë rruga "Agim Ramadani" është në të njëjtën gjendje, pra asfaltimi i dëmtuar me gunga ku vazhdon deri të rruga "Ilir Konushevc" e ma konkretisht deri te rrethi i Komunës.

**Arbnora Berisha, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publiket**

Një marrëveshje e lidhur mes Kryetarit apo Komunës së Prishtinës me operator privat për transport, d.m.th në lidhje me kontratën tetë vjeçare që është nënshkruar me 24 operatorë privat për transportin publik. Si është përfshi me Statutin e Kryetarit për reformën e transportit, ku sipas Kryetarit Rama me këtë kontratë do bëhen reforma dhe do të autobusëve të rinjë, pyes. Pyetja ime është: Cka përfshihet në këtë kontratë dhe reforma, a do ketë orarë të shpeshta dhe të rregullta te këtyre linjave të autobusëve, pasi që ditëve të vikendit linjat private nuk kanë fare transport.

Lidhur me pyetjet e parashytruara për Drejtorin e Shërbimeve Publike, përgjigje dha Bekim Brestovci. Drejtor.

**Arbër Limani, për drejtorin e Drejtorisë së Inspeksionit**

**Banorët e lagjes Ulipiana D/9**, e kanë një shqetësim dhe kanë bërë një petecion për uzurpim të pronës, është uzurpu bodrumi i banesës ku aty ka filluar të bëhet një ndërtim dhe janë prek muret e banesës. Banorët kërkojnë që të kthehet në gjendjen e mëparshme ashtu si ka qenë.

**Gëzim Mehmeti** tha se nga një qytatari të Prishtinës kam pas një pyetje se rruga "A", a do të ketë rrugën Em-25 deri në rrugën "A".

Deri ku kanë shku procedurat për një nënkalim në rrugën "A".

**Granit Geci, për drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike**

Kryetari i Komunës që i ka nënshkru disa kontrata me disa operatorë privatë të cilët merren me transportin publikë, mirëpo nuk kam pa më herët që kanë pasë aq që janë afatëgjate realishtë unë nuk e di a është praktikë që u bë tash, apo si është sepse nuk e di që ka ndodhë më herët janë nënshkru për tetë vite tjetra. Kontratat pra që bëhen me

operatortë privat, kam disa paqartësi ndoshta kam edhe mungesë të informacioneve, kështu që kisha kërku prej juve informacione ma të hollësishme.

Për pyetjet e parashtruara nga z. Geci, përgjigje dha Bekim Brestovci, drejtor.

### **Pika e njëmbëdhjetë Të ndryshme**

**Gëzim Sveçla** tha se duke i parë zhvillimet e fundit që janë duke u bërë ku ka tendencë të vazhdueshme prej ekzekutivit në ndërmarrje komunale por edhe nëpër drejtori me realizuar kontrata shumë të dyshimta të cilat nuk janë në interes të përgjithshëm të Komunës së Prishtinës, me ju bërë apel të gjithë aksionarëve që janë nëpër ndërmarrje komunale, të gjitha bordeve që të kenë shumë kujdes në veprimet e tyre për shkak se përgjegjësia do të bie edhe mbi ta.

Këto ditë ka filluar një proces gjyqësor lidhur me Ndërmarrjen Publike Banesore ku të akuzuar janë ish-anëtarë të Bordit, kryeshefa ekzekutivë, aksionarë edhe me i paralajmëruar të gjithë se fati i njëjtë ka me i përcjell të gjithë ata të cilët marrin veprime që janë në kundërshtim me interesin e përgjithshëm të Komunës së Prishtinës. Po dëgjojmë raste për "Sport Marketing" ku po planifikohet të jepen kontrata që nuk janë dhënë asnjëherë në kohëzgjatje pesëvjeçare, e përmendëm pak më herët rastin e "Pallatit të Rinisë", do të thotë një varg veprimesh intensiteti i të cilave është shtuar tani. Prandaj është thirrje apeli që çdo njëri të qëndrojë në mbrojtje të pasurisë publike dhe me të bie pre e interesave personale ose grupeve të kujtdoqoftë. Parësore është kryerja e detyrës ashtu siç parashihet dhe me ato autorizime që i kanë.

**Leutrim Retkoceri** tha se kjo gjendje që është në Kuvend tani i demanton më së miri paraqitjet publike të kryetarit, ku pa të drejtë dhe në formë të mashtrimit e akuzon Kuvendin për bllokim, e nuk vjen me i shty përpara pikat dhe seancat që i thërret vetë. Kjo është e paprecedent edhe në qeverisjet më të dobëta që i ka pasur Kuvendi i Prishtinës.

*Mbledhja përfundoi në orën 18:00.*

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Fehmi Kupina**



Faqe12nga12